



RELACION
PËR
PROJEKTVENDIMIN
PËR
“MIRATIMIN E UDHËZUESIT TË PUNËS PËR KOMISIONET E ZONAVE TË
ADMINISTRIMIT ZGJEDHOR DHE GRUPET E NUMËRIMIT TË VOTAVE, PËR
ZGJEDHJET PËR KUVENDIN E REPUBLIKËS SË SHQIPËRISË”

I. VLERËSIMI I LIGJSHMËRISË DHE HARMONIZIMI ME LEGJISLACIONIN NË FUQI

Në mbështetje të nenit 20, të ligjit nr. 10019, datë 29.12.2008, “Kodi Zgjedhor i Republikës së Shqipërisë”, të ndryshuar, Komisioni Rregullator shqyrton dhe miraton projektaktet me karakter normativ, të përgatitura nga administrata e KQZ-së udhëzuesit dhe doracakët në shërbim të administratës zgjedhore, subjekteve zgjedhore dhe zgjedhësve.

Në mbështetje të Dekretit të Presidentit nr. 399, datë 5.12.2024, “Për caktimin e datës së zgjedhjeve për Kuvend, të datës 11 maj 2025”, Komisioni Rregullator mori në shqyrtim udhëzuesin e punës për Komisionet e Zonave të Administrimit Zgjedhor dhe Grupet e Numërimit të Votave për zgjedhjet për Kuvendin e Republikës së Shqipërisë.

Duke vlerësuar nga pikëpamja e objektit që trajton ky projektvendim, vlerësohet nga ana e ligjshmërisë së është në kompetencë të Komisionit Rregullator për ta shqyrtuar.

II. PËRMBLEDHJE SHPJEGUESE E PËRMBAJTJES SË PROJEKTAKTIT

Udhëzuesi i punës për Komisionet e Zonave të Administrimit Zgjedhor dhe Grupet e Numërimit të Votave ka për qëllim të detajojë detyrat dhe mënyrën e funksionimit të KZAZ-së dhe të anëtarëve të Grupit të Numërimit të Votave, gjatë procesit të numërimit të votave dhe nxjerrjes së rezultatit të zgjedhjeve për Zonën e Administrimit Zgjedhor për zgjedhjet për Kuvendin e Shqipërisë.

Ky udhëzues iu vjen në ndihmë trajnerëve të administratës zgjedhore për zhvillimin e trajnimeve me anëtarët e Komisioneve të Zonave të Administrimit Zgjedhor si dhe anëtarëve të Komisioneve të Qendrave të Votimit.

Në udhëzues janë parashikuar rregullat që duhet të zbatohen në Vendin e Numërimit të Votave, veprimet paraprake të KZAZ për fillimin e procesit të numërimit të votave. Procesi i numërimit të votave është qartësuar sipas ndarjeve në nënpika duke filluar nga veprimet që kryen KZAZ dhe GNV, për fillimin e procesit të numërimit të votave; Hapja e kutisë së fletëve të votimit; Numërimi



i fletëve të votimit; vlerësimi i tyre, vlerësimi i votës, kontestimi dhe rivlerësimi i votës. Gjuha e përdorur është e thjeshtë dhe e kuptueshme. Fjalitë janë të shkurtra dhe janë përcaktuar hapat që KZAZ dhe GNV ndjekin në çdo fazë të procesit.

Udhëzuesi sqaron rrethanat që çojnë në hapjen e kutisë së materialeve të votimit dhe veprimet që kryen GNV me kutinë e materialeve të votimit në rastin kur procesverbali për mbylljen e votimit nuk gjendet në kutinë e materialeve të votimit apo veprimet që GNV kryen kur ky procesverbal gjendet në këtë kuti.

Një proces tjetër i trajtuar përgjatë udhëzuesit është ai që lidhet me nxjerrjen e rezultatit të zgjedhjeve nga GNV në qendrën e votimit. Gjithashtu në të trajtohet edhe plotësimi i tabelës së rezultateve dhe dërgimi i tyre në KQZ.

Për sa më sipër, në këtë relacion, Komisioneri Shtetëror i Zgjedhjeve, brenda kompetencave dhe në respektim të detyrimeve e afateve ligjore të përcaktuara në ligjin nr. 10019, datë 29.12.2008, “Kodi Zgjedhor i Republikës së Shqipërisë”, të ndryshuar, i propozon Komisionit Rregullator për shqyrtim dhe miratim projektvendimin “Për miratimin e udhëzuesit të punës për Komisionet e Zonave të Administrimit Zgjedhor dhe Grupeve të Numërimit të Votave, për zgjedhjet në Kuvendin e Republikës së Shqipërisë” .

Erion META

–Drejtorja e Administratës Zgjedhore

Pavlina DOÇAJ

–Drejtorja e Ligjshmërisë

Majlinda ÇELMETA

–Sekretar i Përgjithshëm (në mungesë dhe me urdhër)





REPUBLIKA E SHQIPËRISË
KOMISIONI QENDROR I ZGJEDHJEVE
KOMISIONI RREGULLATOR

Data:

Nr:

Ora:

PROJEKTVENDIM

PËR

“MIRATIMIN E UDHËZUESIT TË PUNËS TË KOMISIONEVE TË ZONAVE TË
ADMINISTRIMIT ZGJEDHOR DHE GRUPEVE TË NUMËRIMIT TË VOTAVE PËR
ZGJEDHJET PËR KUVENDIN E REPUBLIKËS SË SHQIPËRISË”

Në mbështetje të nenit 20, pika 1, shkronja “gj”, nenit 115 e vijues, të ligjit 10019, datë 29.12.2008, “Kodi Zgjedhor i Republikës së Shqipërisë”, të ndryshuar, me propozimin e Komisionerit Shtetëror të Zgjedhjeve, Komisioni Rregullator

V E N D O S I:

1. Miratimin e udhëzuesit të punës të Komisioneve të Zonave të Administrimit Zgjedhor dhe Grupet e Numërimit të Votave për zgjedhjet për Kuvendin e Republikës së Shqipërisë, sipas materialit bashkëlidhur këtij vendimi.
2. Ngarkohet Komisioni Qendror i Zgjedhjeve dhe institucionet e tjera të ngarkuara me detyra nga ky vendim, për zbatimin e tij.
3. Ky vendim hyn në fuqi menjëherë dhe publikohet në faqen zyrtare të internetit të Komisionit Qendror të Zgjedhjeve.
4. Kundër këtij vendimi mund të bëhet ankim në Kolegjin Zgjedhor Gjyqësor pranë Gjykatës Administrative të Apelit Tiranë, brenda 5 (pesë) ditëve nga shpallja e tij.

Ilirjana NANO

Kryetar

Arens ÇELA

Anëtar

Dritan ÇAKA

Anëtar

Helga VUKAJ

Anëtar

Muharrem ÇAKAJ

Anëtar

Data: 00.00.2025

Nr: 000
Ora: 00:00



“Për miratimin e udhëzuesit të punës të Komisioneve të Zonave të Administrimit Zgjedhor dhe Grupet e Numërimit të Votave për zgjedhjet për Kuvendin e Republikës së Shqipërisë”

**UDHËZUESI I PUNËS PËR KOMISIONET E ZONAVE TË ADMINISTRIMIT ZGJEDHOR
DHE GRUPET E NUMËRIMIT TË VOTAVE PËR ZGJEDHJET PËR KUVENDIN E
REPUBLIKËS SË SHQIPËRISË**

Formatted: Top: 0.89"

Përmbajtja

<u>I. Rregulla të etikës.....</u>	<u>2</u>
<u>II. Emërimi i GNV nga KZAZ.....</u>	<u>2</u>
<u>III. Rregulla në vendin e numërimit të votave.....</u>	<u>3</u>
<u>IV. Radha e numërimit të votave.....</u>	<u>4</u>
<u>V. Llojet e votave dhe kriteret e vlerësimit të tyre</u>	<u>4</u>
<u>VI. Veprime paraprake të KZAZ</u>	<u>5</u>
<u>VII. Procesi i numërimit të votave</u>	<u>Error! Bookmark not defined.</u>
<u>VIII. Hapja e kutisë së materialeve të votimit</u>	<u>9</u>
<u>IX. Nxjerrja e rezultatit të zgjedhjeve për subjektet zgjedhor për QV</u>	<u>12</u>
<u>X. Nxjerrja e rezultatit të zgjedhjeve për kandidatët.....</u>	<u>14</u>
<u>XI. Disa rregulla për mbledhjen, administrimit dhe publikimin e rezultatit të zgjedhjeve.....</u>	<u>15</u>
<u>XII. Dërgimi i materialeve zgjedhore në KOZ.....</u>	<u>15</u>

Formatted: Font: Times New Roman, 12 pt

Formatted: Font: (Default) Times New Roman, 12 pt

Formatted: Font: (Default) Times New Roman, 12 pt

Formatted: Font: (Default) Times New Roman, 12 pt

Formatted: Font: (Default) Times New Roman, 12 pt

Formatted: Font: Times New Roman, 12 pt

Formatted: Font: (Default) Times New Roman, 12 pt

Formatted: Font: (Default) Times New Roman, 12 pt

Formatted: Font: (Default) Times New Roman, 12 pt

Formatted: Font: Times New Roman, 12 pt

Formatted: Font: (Default) Times New Roman, 12 pt

Formatted: Font: (Default) Times New Roman, 12 pt

Formatted: Font: (Default) Times New Roman, 12 pt

Formatted: Font: (Default) Times New Roman, 12 pt

Formatted: Font: (Default) Times New Roman, 12 pt

Formatted: Font: (Default) Times New Roman, 12 pt

Formatted: Font: (Default) Times New Roman, 12 pt

Formatted: Font: (Default) Times New Roman, 12 pt

Formatted: Font: Times New Roman, 12 pt

Formatted: Font: Times New Roman, 12 pt

Formatted: Font: Times New Roman, 12 pt

Formatted: Font: Times New Roman, 12 pt

Formatted: Font: Times New Roman, 12 pt

Formatted: Font: Times New Roman, 12 pt

Formatted: Font: Times New Roman, 12 pt

Formatted: Font: Times New Roman, 12 pt

Formatted: Font: Times New Roman, 12 pt

Formatted: Font: (Default) Times New Roman

Formatted: Left

Ky udhëzues ka për qëllim të detajojë detyrat dhe mënyrën e funksionimit të KZAZ-së dhe të anëtarëve të Grupit të Numërimit të Votave gjatë procesit të numërimit të votave dhe nxjerrjes së rezultatit të zgjedhjeve për Zonën e Administrimit Zgjedhor për zgjedhjet për Kuvend.

Informacion mbi organizimin e Vendit të Numërimit të Votave, caktimin e grupeve të marrjes në dorëzim dhe detyrat e tyre, janë shpjeguar në materialin ndihmës për KZAZ.

I. Rregulla të etikës

Komisioni i Zonës së Administrimit Zgjedhor dhe Grupet e Numërimit të Votave zbatojnë parimet për ligjshmëri, objektivitet, përgjegjshmëri, transparencë, paanshmëri, profesionalizëm në përputhje me Kodin Zgjedhor dhe aktet e KQZ-së. Komisioni i Zonës së Administrimit Zgjedhor dhe Grupet e Numërimit të Votave, duhet të shmangin rrethanat e konfliktit të interesit duke e deklaruar atë. Rastet e shkeljes së dispozitave të Kodit Zgjedhor, i ngarkojnë anëtarët e komisioneve zgjedhore me përgjegjësi penale dhe administrative, sipas legjislacionit. Ndershmëria, korrektësia, përkushtimi, etika në komunikim janë tipare të rëndësishme për anëtarin e Komisionit të Zonës së Administrimit Zgjedhor dhe për anëtarin e Grupit të Numërimit të Votave. Puna korrekte e tyre do të sigurojë që vullneti i zgjedhësit/votuesit të materializohet në numërimin korrekt të çdo vote.

Formatted: Font: (Default) Times New Roman

II. Emërimi i GNV nga KZAZ

Çdo GNV përbëhet nga 4 anëtarë, ku një anëtar emërohet nga KZAZ pas propozimit të partisë politike së cilës i përket kryetari i KZAZ dhe një anëtar tjetër pas propozimit të partisë politike së cilës i përket nënkryetari i KZAZ. Përcaktimi se cilës parti i takon e drejta e propozimit për anëtarin e tretë apo të katërt i takon KQZ e cila organizon shortin për këtë qëllim.

KZAZ për emërimin e GNV kryen këto veprime:

- u kërkon, me shkrim, partive politike, të cilat kanë të drejtë të propozojnë anëtarë të GNV-ve, të paktën 12 ditë para datës së zgjedhjeve, të dorëzojnë propozimet për emërimin e anëtarëve të GNV-ve. Propozimet, për anëtarë të GNV, i paraqiten KZAZ-së edhe nga degët lokale të partive politike, kur partitë politike ua kanë deleguar të drejtën e propozimit.
- Merr vendimin jo më vonë se 10 ditë ditë para datës së zgjedhjeve për emërimin e anëtarëve të grupit të numërimit të votave, ku emëron një nga anëtarët si numërues të parë dhe një anëtar si sekretar.

Në gjysmën e Grupeve të Numërimit të Votave numëruesi i parë propozohet nga partia më e madhe e shumicës dhe në gjysmën tjetër nga partia më e madhe e pakicës parlamentare. Sekretari i Grupit të Numërimit të Votave i përket partisë politike të kundërt me partinë që propozon numëruesin e parë.

Formatted: Font: (Default) Times New Roman

KZAZ numëron GNV-të me numra natyrorë duke filluar nga numri 1 (një) e duke vazhduar në rend rritës deri në numërtimin e të gjitha GNV.

Formatted: Font: (Default) Times New Roman

Në GNV me numër çift, numëruesi i parë propozohet nga partia politike që ka kryetarin e KZAZ, ndërsa sekretari i GNV propozohet nga partia politike që ka nënkryetarin e KZAZ.

Në GNV me numër tek, numëruesi i parë propozohet nga partia politike që ka nënkryetarin e KZAZ, ndërsa sekretari i GNV propozohet nga partia politike që ka kryetarin e KZAZ.

- Në rast se, një parti politike nuk paraqet propozim të paktën 12 ditë nga data e zgjedhjeve, KZAZ me vendim cakton anëtarët zëvendësues. Anëtarët zëvendësues caktohet me short ndërmjet anëtarëve të KQV-ve që i përkasin të njëjtës parti politike në Zonën e Administrimit Zgjedhor. Anëtarët e KQV-ve, të përzgjedhur nga sekretari i KZAZ, renditen, në mënyrë rastësore, në lista, sipas partive politike të cilat i kanë propozuar. Çdo emri të renditur i vendoset një numër rendor rritës duke filluar nga 01. Vendosen shirita letre në një enë transparente, ku janë shënuar numrat rendorë që i korrespondojnë çdo anëtari të KQV-së të partisë politike përkatëse të renditur në listë, të cilat tërhiqen nga kryetari i KZAZ, aq sa është numri i anëtarëve që mungojnë. Anëtari i KQV-së, i emëruar me propozim të partisë politike, për të cilën hidhet shorti, të cilit i korrespondon numri rendor i shënuar në shiritin e letrës së tërhequr, caktohet anëtar i Grupit të Numërimit të Votave.
- Partitë politike, të cilat kanë të drejtën të paraqesin propozimin për anëtarin e tretë ose të katërt të GNV, dhe nuk kanë anëtarë në KQV, humbasin të drejtën të paraqesin anëtar të GNV, nëse nuk propozojnë anëtarin të paktën 12 ditë nga data e zgjedhjeve.
- Në rast se nuk është i mundur plotësimi i numrit të anëtarëve të Grupit të Numërimit të Votave, ai funksionon me jo më pak se dy anëtarë.

Formatted: Font: (Default) Times New Roman

III. Rregulla në vendin e numërimit të votave

- Grupet e marrjes në dorëzim, në asnjë rast, nuk mund të refuzojnë marrjen në dorëzim të kutisë së votimit me fletët e votimit, të kutisë me materialet e votimit të çdo QV-je apo materialeve të tjera të logjistikës zgjedhore të cilat dorëzohen nga KQV-të në VNV.
- KZAZ-ja, pas marrjes në dorëzim të materialit zgjedhor, dërgon elektronikisht në KQZ informacionin për Qendrat e votimit në të cilat zgjedhjet nuk janë zhvilluar, (nëse ka), apo kutitë e votimit dhe kutitë e materialeve zgjedhore të cilat janë vlerësuar si “Kuti të parregullta”, (nëse ka).
- Grupet e numërimit të votave kryejnë, në mënyrë të pandërprerë, numërimin e të gjitha kutive të pranura të rregullta nga ana e KZAZ-së. Refuzimi për të numëruar sjell shkarkimin e menjëhershëm të personave të ngarkuar për numërimin ose, sipas rastit, KZAZ-së. Refuzimi për të numëruar kutinë e pranuar si të rregullt përbën vepër penale dhe ndëshkohet sipas nenit 330/a të Kodit Penal.
- Procesi i numërimit ndërpritet me vendim të KZAZ-së, vetëm për shkaqe që nuk varen nga administrata zgjedhore dhe që pengojnë procesin normal të numërimit. Shkaqet argumentohen

Formatted: Font: (Default) Times New Roman

në “Librin e Protokollit të Mbledhjeve” të KZAZ-së, përfshirë dhe vendimin për rifillimin e numërimit.

- KZAZ kujdeset, gjatë gjithë kohës, nga momenti i fillimit të procesit të numërimit të votave në VNV dhe deri në nxjerrjen e rezultatit të Zonës së Administrimit Zgjedhor, për ruajtjen nga dëmtimet e jashtme të teknologjisë mbështetëse të instaluar në VNV dhe në çdo tavolinë numërimi.
- KZAZ merr masa dhe është përgjegjëse për personat të cilët lejohen të ndjekin procesin e numërimit të votave në VNV. KZAZ lejon, në VNV, anëtarët e grupit të numërimit të votave të caktuar me vendim të KZAZ, vëzhguesit e akredituar të subjekteve zgjedhore dhe vëzhgues të tjerë të akredituar, kandidatët, përfaqësuesit e akredituar të medias, operatorët e teknologjisë mbështetëse të numërimit të votave, personelin teknik për mbarëvajtjen e sistemit të kamerave, stafin e KQZ, të pajisur me autorizim të posaçëm nga KQZ.
- Përveç këtyre personave, KZAZ nuk lejon, në VNV, persona të tjerë. Në rast të pranisë së personave të tjerë, KZAZ-ja, me vendim, njofton menjëherë punonjësit e Policisë së Shtetit dhe rasti mbahet shënim në Librin e Protokollit të Mbledhjeve të KZAZ-së, duke përfshirë edhe orën e saktë të ardhjes dhe largimit të punonjësve të Policisë së Shtetit.

Formatted: Font: (Default) Times New Roman

IV. Radha e numërimit të votave

1. Numërimi fillon me votat për subjektet zgjedhore dhe më pas vijon me numërimin e votave të kandidatëve.
2. Numërimi i votave për kandidatët fillon vetëm pasi ka mbaruar numërimi i votave për subjektet zgjedhore.
3. Procedura dhe rregullat që ndiqen në procesin e numërimit të votave janë të njëjta si për numërimin e votave për subjektet zgjedhore ashtu edhe për kandidatët.

Formatted: Font: (Default) Times New Roman

V. Llojet e votave dhe kriteret e vlerësimit të tyre

Konsiderohet votë e vlefshme kur zgjedhësi ka votuar në fletët e votimit qartësisht vetëm për njërin nga subjektet zgjedhore dhe/ose njërin nga kandidatët e atij subjekti zgjedhor. Kur zgjedhësi ka votuar për më shumë se një kandidat të të njëjtit subjekt zgjedhor, vota llogaritet në favor të subjektit zgjedhor, por jo të kandidatëve.

Formatted: Font: (Default) Times New Roman

Konsiderohet votë e pavlefshme kur fleta e votimit:

- Nuk ka të njëjtën madhësi, ngjyrë ose formë me fletën e votimit të miratuar nga KQZ-ja.
- I mungojnë një ose dy vulat në pjesën e pasme të saj, përkatësisht vulën e KQV si dhe atë të kryetarit të KQV.
- Janë bërë shënime në favor apo disfavor të subjekteve të caktuara zgjedhore.
- Ka shenja që bëjnë të pamundur vlerësimin e votës.

- Është votuar për më shumë se një subjekt zgjedhor apo është votuar për një subjekt zgjedhor dhe për kandidatin e një subjekti tjetër zgjedhor.
- Zgjedhësi nuk ka votuar në fletën e votimit për asnjë nga subjektet zgjedhore/kandidatët.
- Zgjedhësi ka votuar për një person apo subjekt që nuk është në fletën e votimit.

Grupi i Numërimit të Votave, për vlerësimin e çdo vote synon të identifikojë sa të jetë e mundur qëllimin e zgjedhësit.

Formatted: Font: (Default) Times New Roman

VI. Veprime paraprake të KZAZ

Përpara se të fillojë procesi i numërimit, KZAZ :

- Sigurohet se ka marrë në dorëzim të gjitha kutitë e votimit me fletët e votimit dhe kutitë e materialeve të votimit.
- Verifikon që anëtarët e Grupeve të Numërimit janë prezent në VNV dhe janë të ulur në tavolinat përkatëse të numërimit.
- Verifikon që anëtarët e Grupeve të Numërimit janë të pajisur me materialet e nevojshme logjistike për procesin e numërimit të votave dhe kanë marrë trajnimin e nevojshëm.
- Sigurohet që Vendi i Numërimit të Votave është gati për fillimin e procesit të numërimit të votave.
- Verifikon që të pranishëm në VNV janë vetëm personat që janë të pajisur me dokumentacionin përkatës akreditim, autorizim apo vërtetim, sipas rastit, nga KQZ apo KZAZ. Ajo verifikon dokumentin e identifikimit të këtyre personave.
- Merr konfirmimin nga operatori teknik për funksionimin normal të teknologjisë mbështetëse të numërimit të votave.

Të gjitha veprimet e mësipërme të KZAZ-së shënohen në Librin e Protokollit të Mbledhjeve.

Formatted: Font: (Default) Times New Roman

VII. PROCESI I NUMËRIMIT TË VOTAVE

1. Veprime për fillimin e procesit të numërimit të votave

Formatted: Font: (Default) Times New Roman

KZAZ dhe GNV janë përgjegjës për këto detyra:

Formatted: Font: (Default) Times New Roman

Hapi 1:

- KZAZ ka në dorëzim të gjitha kutitë e votimit me fletët e votimit dhe kutitë e materialeve të votimit nga të gjitha QV-të në juridiksionin e saj.
- KZAZ merr vendim për fillimin e procesit të numërimit të votave ku shënohet ora e saktë e fillimit të procesit të numërimit të votave.

- Sekretari i KZAZ shënon orën e fillimit të procesit të numërimit të votave në “Librin e Protokollit të Mbledhjeve” të KZAZ-së.
- Sekretari i KZAZ-së njofton menjëherë KQZ-në për fillimin e numërimit të kutisë së parë të KZAZ-së.

Formatted: Font: (Default) Times New Roman

Hapi 2:

Sekretari i Grupit të Numërimit nën kujdesin e një anëtarit të ngarkuar nga KZAZ-ja:

- Merr me radhë dhe sipas numrit rendor rritës të qendrave të votimit, kutinë e votimit me fletët e votimit të vetëm një Qendre Votimi
- Vendos kutinë me fletët e votimit pranë tavolinës së Grupit të Numërimit;
- Vendos/ngjit në tavolinën e përcaktuar nga KZAZ etiketën adezive dhe shkruan numrin e qendrës së votimit që numërohet;
- Merr nga sekretari i KZAZ-së, dosjen e KQV-së përkatëse, e cila është plotësuar gjatë dhënies së bazës materiale zgjedhore nga KZAZ-ja në KQV.

2. Hapja e kutisë së votimit

Hapi 1:

Numëruesi i parë:

- Vendos mbi tavolinën e numërimit kutinë me fletët e votimit.
- Ekspozon kutinë e votimit në kamera për jo më pak se 2 sekonda në faqen anësore ku është vendosur etiketa me numrin e qendrës së votimit.
- Këput vulat me kodet e sigurisë.
- Nxjerr nga kutia e votimit “Procesverbalin e Mbylljes së Votimit”.

Hapi 2:

Grupi i numërimit të votave:

- Verifikon të dhënat e plotësuara në procesverbalin e mbylljes së votimit.
- Nxjerr nga kutia fletët e votimit dhe zarfin me “Procesverbalin e Vulosjes së kutisë së votimit”.
- Shpalos fletët e votimit dhe i vendos ato mbi tavolinën e numërimit me pjesën e pasme të fletës nga ana e sipërme.

Fillon procedurat për numërimin e votave dhe vlerësimin e fletëve të votimit, nëse procesverbali për mbylljen e votimit gjendet në kutinë me fletët e votimit dhe është plotësuar saktë.

3. Numërimi i fletëve të votimit

KZAZ dhe GNV janë përgjegjës për këto detyra:

Hapi 1:

Numëruesi i parë i GNV:

- Numëron fletët e votimit të shpalosura dhe të stivuara.

- Bën të ditur shifrën anëtarëve të grupit të numërimit të votave si dhe vëzhguesve të subjekteve zgjedhore.
- Verifikon shifrën e deklaruar me shifrën për pjesëmarrjen e zgjedhësve të shënuar në “Procesverbalin për mbylljen e votimit”.
- Rifillon numërimin e fletëve të votimit:
 - i. nëse shifra nuk përputhet,
 - ii. nëse kërkohet rinumërim nga ndonjë prej anëtarëve të GNV.

Hapi 2:

Kur konstatohen mospërputhje bëhen këto veprime:

- Anëtari i GNV ose vëzhgues të subjekteve zgjedhore që bën konstatimin, njofton KZAZ, pa lëvizur nga vendi dhe duke ngritur dorën.
- KZAZ verifikon rastin. Derisa KZAZ të verifikojë rastin, procesi mbetet i pezulluar dhe GNV nuk kryen veprime të mëtejshme.
- Sekretari i KZAZ pasqyron pasaktësinë në Procesverbalin e Konstatimit vetëm pasi KZAZ e ka konfirmuar atë.
- KZAZ merr vendim për vazhdimin e procedurave të numërimit të votave nga GNV-ja dhe ky vendim i njoftohet GNV.

4. Vlerësimi i fletëve të votimit nga faqja e pasme

Hapi 1:

- GNV-ja, në tavolinën e numërimit, përcakton vendet e veçanta për fletët e votimit: të vlefshme, të pavlefshme, të kontestuara.
- GNV, në tavolinën e numërimit, në hapësirën e caktuar për votat e vlefshme, përcakton vende të veçanta për grupe të fletëve të votimit të vlefshme për çdo subjekt zgjedhor/kandidat.

Hapi 2:

Numëruesi i parë:

- Hap në mënyrë të plotë çdo fletë votimi;
- I vendos një nga një fletët e votimit në kamerën regjistruese, fillimisht nga faqja e pasme, jo më pak se 3 sekonda, në mënyrë që të shihen qartë në monitor vula e KQV-së dhe Vula e Kryetarit të KQV-së;
- Verifikon nëse fleta e votimit ka të njëjtën madhësi, formë dhe ngjyrë, me fletën e votimit të miratuar nga KQZ-ja, është vulosur me vulën e KQV-së dhe me vulën e Kryetarit të KQV-së;
- Verifikon nëse ka shënime, shenja apo nënshkrime, që bëjnë të mundur identifikimin e zgjedhësit;
- Shprehet me zë të lartë vetëm për fletët e votimit, të cilat i konsideron të pavlefshme gjatë vlerësimit nga faqja e pasme.

- Vendos fletën e votimit të vlerësuar të pavlefshme në vendin e caktuar për votat e pavlefshme mbi tavolinën e punës së GNV-së.
- Në rast se ndonjë nga anëtarët e GNV ose ndonjë prej vëzhguesve të subjekteve zgjedhore, nuk është dakord me vlerësimin e numëruesit të parë, ai e vendos fletën e votimit të kundërshtuar në vendin e përcaktuar për fletët e votimit të kontestuara (e cila do të vlerësohet përsëri nga GNV në momentin e rivlerësimit të votave) dhe vijon me fletën tjetër të votimit.

5. Vlerësimi i votave

Vlerësimi i votave fillon menjëherë pas vlerësimit të fletës së votimit nga faqja e pasme.

Hapi 1 :

Numëruesi i parë

- vlerëson votën se për cilin subjekt zgjedhor ka votuar zgjedhësi.
- e propozon atë për vlerësim tek anëtarët e tjerë të GNV
- vendos fletën e votimit në kamerën regjistruese, jo më pak se 4 sekonda, në mënyrë që shenja e cila tregon vullnetin e zgjedhësit, të shikohet qartësisht në monitor
- bën vlerësimin e votës me zë të lartë
- fleta e votimit ndahet sipas vlerësimit dhe vendoset në vendin e caktuar për subjektin zgjedhor për të cilin është votuar

Vota e vlefshme identifikon qëllimin e votuesit dhe se është votuar qartësisht vetëm për njërin nga subjektet zgjedhore dhe nuk është në rrethanat e pavlefshmërisë sipas nenit 117 të Kodit Zgjedhor. GNV-ja vlerëson shprehjen e vullnetit të votuesit, duke ju referuar modeleve ilustruese bashkëlidhur këtij udhëzuesi, por pa u kufizuar në to.

Në rast se numëruesi i parë nuk shfaq në kamerën regjistruese një fletë votimi dhe kur ky veprim kontestohet nga anëtarët e GNV-së ose vëzhguesit e subjekteve zgjedhore, KZAZ detyron GNV të shfaqë në kamera fletën e votimit.

6. Kontestimi dhe rivlerësimi i votës

Kontestimi i votës bëhet nga anëtarët e GNV ose çdo vëzhgues i subjekteve zgjedhore i tavolinës përkatëse të numërimit duke ngritur dorën e duke thënë “Nuk jam dakord”. Në këtë rast ndiqen këto hapa:

Hapi 1:

- Numëruesi i parë, e vendos fletën e votimit të kontestuar në vendin e përcaktuar për fletët e votimit të kontestuara dhe vijon me fletën tjetër të votimit.
- GNV rivlerëson fletët e votimit të kontestuara vetëm pasi ka përfunduar vlerësimi i fletëve të votimit të kutisë përkatëse të votimit. Fleta e votimit e kontestuar nuk shfaqet më në kamera.
- GNV informon vëzhguesit për përfundimin e rivlerësimit.

7. Kontestimi i votës së rivlerësuar

Në rast se edhe pas rivlerësimit, mbeten ende fletë votimi të kontestuara, ndiqen këto hapa:

Hapi 1:

- Secili anëtar i GNV thërret KZAZ-në për vlerësimin e fletëve të votimit të kontestuara të asaj kutie.

Hapi 2:

- KZAZ bën vlerësimin e votës
- KZAZ merr vendimin për votë të vlefshme ose të pavlefshme.
- Sekretari i KZAZ shënon rezultatin e shpallur, nga KZAZ, në Librin e Protokollit të Mbledhjeve, rezultat i cili përfshihet në tabelën përkatëse të rezultatit të qendrës së votimit që harton Grupi i Numërimit të Votave.

Hapi 3:

- Numëruesi i parë i Grupit të Numërimit, për secilën fletë të kontestuar, shënon në pjesën e prapme të saj, qartë, arsyet e kontestimit.
- GNV shënon në Procesverbalin përkatës miratuar me vendim të KQZ-së, numrin e përgjithshëm të fletëve të votimit të kontestuara për QV-në përkatëse.
- Në përfundim të nxjerrjes së rezultatit për QV përkatëse, fletët e votimit të cilësuar si të kontestuara dhe procesverbali përkatës futen në zarfin e “Fletë votimi të kontestuara”.

VIII. Hapja e kutisë së materialeve të votimit

1. Rrethanat që çojnë në hapjen e kutisë së materialeve të votimit

Formatted: Font: (Default) Times New Roman

Hapi 1:

- GNV apo vëzhguesit e subjekteve zgjedhore, njoftojnë menjëherë KZAZ-në nëse në kutinë e votimit, mungon procesverbal i mbylljes së votimit ose ky procesverbal nuk është plotësuar saktë. Njoftimi bëhet pa lëvizur nga vendi, duke ngritur dorën.
- GNV pezullon çdo veprim të mëtejshëm, derisa KZAZ-ja të njihet me çështjen dhe ta verifikojë atë.

Formatted: Font: (Default) Times New Roman

Hapi 2:

KZAZ:

- Konfirmon mungesën e “Procesverbalit të Mbylljes së Votimit” në kutinë e votimit, pasaktësi ose parregullsi në plotësimin e tij.
- Pasqyron faktet në “Procesverbalin e Konstatimit”.
- Merr vendim për vazhdimin e procedurave të verifikimit të kutisë së materialeve të votimit dhe pezullimin e numërimit të votave nga Grupi i Numërimit.

- Vendimi i marrë nga KZAZ-ja i bëhet i ditur menjëherë GNV.

Hapi 3:

Numëruesi i parë:

- Vendos kutinë me fletët e votimit, numërimi i së cilës është pezulluar, pranë tavolinës së numërimit
- Merr kutinë e materialeve të votimit të qendrës së votimit përkatëse.

2. Veprimet me kutinë e materialeve të votimit

Kur është marrë vendimi i pezullimit të numërimit të fletëve të votimit, kryhen këto veprime:

- Numëruesi i parë, në tavolinën e numërimit, këput vulat me kodet e sigurisë e kutisë së materialeve të votimit.
- GNV verifikon nëse në kutinë e materialeve të votimit ndodhet procesverbali për Mbylljen e Votimit, i plotësuar në mënyrë të rregullt.

a) Procesverbali për mbylljen e votimit gjendet në kutinë e materialeve të votimit dhe është plotësuar saktë

Hapat që ndiqen janë:

Hapi 1:

- GNV i dorëzon KZAZ-së procesverbalin e mbylljes së votimit.

Hapi 2:

- KZAZ pasqyron faktin në Procesverbalin e Konstatimit.

Hapi 3:

Sekretari i Grupit të Numërimit shënon numrat e kodeve për mbylljen e kutisë së materialeve të votimit, në procesverbalin e Grupit të Numërimit që përdoret në këtë procedurë dhe e fut atë në kutinë e materialeve të votimit. Kopje të tij ia dorëzon KZAZ-së.

Hapi 4:

Numëruesi i parë i Grupit të Numërimit:

- Mbyll kutinë e materialeve të votimit me vulat me kode sigurie.
- Vendos kutinë e materialeve të votimit pranë tavolinës së numërimit
- Merr kutinë e votimit të qendrës së votimit përkatëse, numërimi i së cilës ishte pezulluar.

Hapi 5:

GNV-ja vazhdon me numërimin e votave sipas procedurave të rregullta për numërimin e tyre.

b) Procesverbali për mbylljen e votimit nuk gjendet në kutinë e materialeve të votimit apo nuk është plotësuar saktë

Hapat që ndiqen janë:

Hapi 1:

GNV verifikon nëse në kuti ndodhen:

Formatted: Font: (Default) Times New Roman

Formatted: Font: (Default) Times New Roman

Formatted: Font: (Default) Times New Roman

- zarfi me fletët e votimit të papërdorura,
- zarfi me fletë votimi të dëmtuara,
- zarfi “Vërtetime të identifikimit elektronik të zgjedhësve”.
- raporti i mbylljes së identifikimit elektronik të zgjedhësve të gjeneruar nga PEI,
- lista e zgjedhësve përfshirë edhe regjistrin e posaçëm,
- vulat, përkatësisht të KQV dhe të kryetarit të KQV,
- vulat me kodet e sigurisë të papërdorura, nëse ka,
- vulat me kodet e sigurisë të dëmtuara (nëse ka),
- Librin e Protokollit të Mbledhjeve të KQV-së,
- origjinalet e vendimeve të marra nga KQV.

Hapi 2:

Numëruesi i parë:

- Krahason vulën e kryetarit të KQV-së me modelin krahasues dhe mendimin e tij ia bën të ditur anëtarëve të grupit të numërimit.
- Numëron fletët e votimit të papërdorura dhe të dëmtuara.
- Numëron edhe numrin e zgjedhësve që kanë votuar. Janë tre raste që numëruesi i parë duhet të ketë parasysh në përcaktimin e numrit të zgjedhësve që kanë votuar.

Rasti 1: Zgjedhësit janë identifikuar elektronikisht vetëm nga PEI

Në rastin kur zgjedhësit janë identifikuar vetëm nga PEI, numri i zgjedhësve merret nga raporti i mbylljes PEI.

Rasti 2: Zgjedhësit nuk janë identifikuar elektronikisht

Në rastin kur në qendrën e votimit është zbatuar procedura pa PEI me vendim të KQV-së, numëruesi i parë numëron numrin e zgjedhësve që kanë votuar, sipas nënshkrimeve që kanë bërë në listën e zgjedhësve.

Rasti 3: Zgjedhësit janë identifikuar pjesërisht në mënyrë elektronike

Një rast tjetër është edhe kur një pjesë e procesit të votimit është zhvilluar përmes identifikimit elektronik nga PEI dhe më pas është ndërprerë identifikimi elektronik i zgjedhësve dhe procesi me vendim të KQV ka vijuar me listën e zgjedhësve. Në këtë rast, pajisja nuk ka prodhuar raport me të dhëna. Në këto kushte numëruesi i parë:

- numëron zgjedhësit që kanë votuar sipas nënshkrimeve që kanë bërë në listën e zgjedhësve;
- numëron në regjistrin e posaçëm të zgjedhësve;
- numëron zgjedhësit që janë identifikuar nga PEI sipas numrit të dokumenteve fizikë të administruara në zarfin “Vërtetime të identifikimit elektronik të zgjedhësve”.

Formatted: Font: (Default) Times New Roman

Formatted: Font: (Default) Times New Roman

Formatted: Font: (Default) Times New Roman

Formatted: Font: (Default) Times New Roman

Formatted: Font: (Default) Times New Roman

- I bën të ditur, anëtarëve të Grupit të Numërimit dhe vëzhguesve të subjekteve zgjedhore, shifrën për numrin e zgjedhësve që kanë votuar.
- Rifillon edhe një herë numërimin, nëse kërkohet rinumërim nga ndonjë prej anëtarëve të Grupit të Numërimit.
- Hedh të dhënat për numrin total të fletëve të votimit të dorëzuara në KQV, bazuar në dokumentacionin shoqërues të tyre

- Hedh të dhënat në tabelën për qendrën e votimit
 - për numrin e zgjedhësve që kanë votuar,
 - për fletët e votimit të papërdorura
 - për fletët e votimit të dëmtuara.

Hapi 3:

Sekretari i Grupit të Numërimit, në “Procesverbalin e Mbylljes së Kutisë së Materialeve të Votimit” shënon numrat e kodeve dhe e fut atë në këtë kuti.

Hapi 4:

Numëruesi i parë:

- Mbyll kutinë e Materialeve të Votimit me vulat me kode sigurie.
- I dorëzon KZAZ, kopje të procesverbalit të mbylljes së kutisë së materialeve të votimit.
- Vendos kutinë e Materialeve të Votimit pranë tavolinës së numërimit
- Merr kutinë e votimit të qendrës së votimit përkatëse, numërimi i së cilës ishte pezulluar
- KZAZ shënon në “Librin e Protokollit”, numrat e kodeve të vulave të sigurisë të mbylljes së kutisë së materialeve të votimit.

Formatted: Font: (Default) Times New Roman

Hapi 5:

GNV vazhdon me numërimin e votave, sipas procedurave të rregullta për numërimin e votave.

IX. Nxjerrja e Rezultatit të zgjedhjeve për subjektet zgjedhore për Qendrën e Votimit

Një nga detyrat e GNV është nxjerrja e rezultatit të zgjedhjeve për secilën qendër votimi që GNV ka numëruar. Para se grupi i numërimit të votave të plotësojë tabelën e rezultateve të QV duhet të kontrollojë dhe të sigurohet që numri i fletëve të votimit të gjetura në kuti, të jetë i barabartë me shumën e votave të pavlefshme dhe votave të vlefshme si dhe të sigurohet që numri i votave të vlefshme të jetë i barabartë me shumën e votave të vlefshme të shpërndara për subjektet zgjedhore në fletën e votimit.

1. Plotësimi i tabelës së rezultateve të subjekteve zgjedhore për QV

Në përfundim të procedurave të numërimit dhe vlerësimit të votave për qendrën e votimit, Numëruesi i parë së bashku me anëtarët e Grupit të Numërimit kryejnë këto veprime:

- Plotësojnë me shkrim dore, tabelën e rezultateve të kësaj QV-je, për secilin subjekt zgjedhor, sipas modelit të miratuar nga Komisioneri Shtetëror i Zgjedhjeve.
- Nënshkruajnë tabelën e rezultateve për QV për subjektet zgjedhore.
- Në rast se anëtarët e GNV-së kanë kundërshtime për rezultatet e pasqyruara në tabelë, bëjnë shënimet në rubrikën përkatëse të tabelës së rezultateve të Grupit të Numërimit.

- Numëruesi i parë shfaq në kamera për jo më pak se 4 (katër) sekonda, tabelën e rezultateve të QV, të plotësuar nga anëtarët e Grupit të Numërimit, duke përfshirë dhe kundërshtimet, nëse ka.
- Nëse ka kundërshtime në lidhje me rezultatet e pasqyruara në tabelë nga ndonjë nga vëzhguesit e tavolinës ku u krye numërimi, sekretari i KZAZ shënon këto kundërshtime menjëherë në Librin e Protokollit të KZAZ-së.
- Numëruesi i parë, menjëherë pas shfaqjes të tabelës në monitor, dorëzon dorazi te sekretari i KZAZ, Tabelën e Rezultateve për QV-në, për subjektet zgjedhore.

Formatted: Font: (Default) Times New Roman

2. Dërgimi i rezultateve për çdo QV në KQZ

- KZAZ dërgon në rrugë elektronike në KQZ, për çdo QV, informacionin për rezultatet e zgjedhjeve për çdo QV. Ky proces vazhdon deri në përfundimin e vlerësimit të numërimit të votave dhe dorëzimit të të gjitha tabelave të rezultateve prej GNV.
- Tabela e rezultateve për QV-në, e printuar në 5 (pesë) kopje dhe e firmosur nga anëtarët e GNV, pas verifikimit të saktësisë u jepet, KZAZ-së kopja e parë me shenjë dalluese nga të tjerat, dhe anëtarëve të GNV kopjet e tjera. Anëtarëve të KZAZ si dhe vëzhguesve të subjekteve zgjedhore dhe atyre të akredituar, nëse i kërkojnë, u jepen fotokopje të vulosura nga sekretari i KZAZ me vulën e saj.
- Një kopje e tabelës së rezultatit të GNV, e vulosur me vulën e KZAZ, afishohet nga sekretari i KZAZ-së, në vendin e caktuar në VNV për këtë qëllim.
- Pas plotësimit të Tabelës së Rezultateve të çdo QV-je, KZAZ-ja dërgon elektronikisht, nëpërmjet sistemit në KQZ, informacionin për rezultatin e zgjedhjeve të asaj QV-je.
- KZAZ dërgon në rrugë elektronike në KQZ, për çdo QV, informacionin për rezultatet e zgjedhjeve menjëherë pas marrjes së tabelës së rezultateve nga GNV. Ky proces vazhdon deri në përfundimin e vlerësimit të numërimit të votave dhe dorëzimit të të gjitha tabelave të rezultateve prej GNV.
- Tabela e rezultateve për QV-në, e printuar në 5 (pesë) kopje dhe e firmosur nga anëtarët e GNV, pas verifikimit të saktësisë u jepet, KZAZ-së kopja e parë me shenjë dalluese nga të tjerat, dhe anëtarëve të GNV kopjet e tjera. Anëtarëve të KZAZ si dhe vëzhguesve të subjekteve zgjedhore si dhe atyre të akredituar, nëse i kërkojnë, u jepen fotokopje të vulosura nga sekretari i KZAZ me vulën e saj. Një kopje e tabelës së rezultatit të GNV, e vulosur me vulën e KZAZ, afishohet nga sekretari i KZAZ-së, në vendin e caktuar në VNV për këtë qëllim.

Formatted: Font: (Default) Times New Roman, 12 pt

Formatted: Font: (Default) Times New Roman

3. Mbyllja e kutisë me fletët e votimit

Pas nxjerrjes së rezultatit dhe plotësimit të tabelës së rezultateve të QV-së nga GNV-ja, ndiqen këto hapa:

- GNV, fletët e votimit i fut në zarfe të ndara, sipas subjekteve zgjedhore.
- Fletët e votimit në të cilat është votuar qarësisht vetëm për subjektin zgjedhor vendosen në zarfin “Fletë votimi të vlefshme vetëm për subjektet zgjedhore”. Për këto fletë votimi mbahet

procesverbali “Për votat e vlefshme për partitë politike dhe koalicionet kur nuk ka votim parapëlqyes për kandidatët”.

- Votat e pavlefshme futen në zarfin me shënimin “vota të pavlefshme”.
- Fletët e votimit të kontestuara janë grupuar më vete dhe futen në zarfin me shënimin “fletë votimi të kontestuara”.
- Më pas të gjitha këto zarfe, përfshi zarfin me procesverbalin për Hapjen e Votimit, zarfin me Procesverbalin e Mbylljes së Votimit, dhe zarfin me Procesverbalin e Vulosjes futen në kutinë e votimit e cila mbyllet me vula me kode sigurie të reja. Kopje e procesverbalit të vulosjes i dorëzohet sekretarit të KZAZ-së, i cili përgjigjet për administrimin e tyre si dhe vëzhguesve të subjekteve zgjedhore.
- Kutia e numëruar vendoset në vendin e caktuar brenda sallës së Vendit të Numërimit të Votave. Grupi i Numërimit merr nga stiva e kutive të votimit, kutinë me fletët e votimit të qendrës tjetër të votimit.

Formatted: Font: (Default) Times New Roman

4. Tabela Përmbledhëse e Rezultateve për Subjektet Zgjedhore

Menjëherë pas përfundimit të procesit të numërimit të të gjitha kutive të votimit për subjektet zgjedhore, sekretari i KZAZ-së kërkon nga operatori të printojë nga baza elektronike e të dhënave Tabelën Përmbledhëse të Rezultateve të Zgjedhjeve të ZAZ, për subjektet zgjedhore, në të cilën pasqyrohen rezultatet e çdo subjekti zgjedhor për çdo qendër votimi. KZAZ miraton tabelën përmbledhëse të rezultateve për subjektet zgjedhore përmes vendimit përkatës sipas modelit të miratuar nga KSHZ.

Pas miratimit, sekretari i KZAZ-së udhëzon operatorin të skanojë dhe dërgojë në rrugë elektronike, në KQZ:

- Tabelën Përmbledhëse të Rezultateve të ZAZ-së për subjektet zgjedhore.
- Vendimin e KZAZ për miratimin e tabelës përmbledhëse të rezultatit të subjekteve zgjedhore.

Në rast se KZAZ nuk arrin të marrë vendim për miratimin e Tabelës Përmbledhëse të Rezultateve për subjektet zgjedhore, çështja dërgohet për shqyrtim në KQZ, nga kryetari apo së paku dy anëtarë të KZAZ.

Kopje të Tabelës Përmbledhëse të Rezultateve, të vulosura nga sekretari i KZAZ-së me vulën e KZAZ-së, u jepen anëtarëve të KZAZ-së dhe vëzhguesve të subjekteve zgjedhore dhe atyre të akredituar, nëse i kërkojnë.

X. Nxjerrja e Rezultatit të zgjedhjeve për kandidatët

Një nga detyrat e GNV është nxjerrja e rezultatit të zgjedhjeve për secilën qendër votimi që GNV ka numëruar, për kandidatët. Procedura që ndiqet është e njëjtë me procedurën e ndjekur për numërimin e subjekteve zgjedhore. GNV numëron dhe vlerëson votat e kandidatëve për çdo QV dhe plotëson tabelën e rezultateve për kandidatët për çdo QV.

Tabela Përmbledhëse e Rezultateve për kandidatët

Formatted: Font: (Default) Times New Roman

Pas numërimit të të gjitha kutive të votimit për kandidatët, sekretari i KZAZ-së i kërkon operatorit të printojë nga baza elektronike e të dhënave e krijuar nga hedhja në të e rezultateve të të gjitha QV-ve, Tabelën Përmbledhëse të Rezultateve të Zgjedhjeve të ZAZ-së për kandidatët.

KZAZ miraton tabelën përmbledhëse të rezultateve për kandidatët përmes vendimit përkatës sipas modelit të miratuar nga KSHZ.

Pas miratimit, sekretari i KZAZ-së udhëzon operatorin të skanojë dhe dërgojë në rrugë elektronike, në KQZ, Tabelën Përmbledhëse të Rezultateve të ZAZ-së për kandidatët dhe vendimin e KZAZ për miratimin e tabelës përmbledhëse të rezultatit të kandidatëve.

Në rast se KZAZ nuk arrin të marrë vendim për miratimin e Tabelës Përmbledhëse të Rezultateve për kandidatët, çështja dërgohet për shqyrtim në KQZ, nga kryetari apo së paku dy anëtarë të KZAZ.

Kopje të Tabelës Përmbledhëse të Rezultateve, të vulosura nga sekretari i KZAZ-së me vulën e KZAZ-së, u jepen anëtarëve të KZAZ-së dhe vëzhguesve të subjekteve zgjedhore, nëse i kërkojnë.

XI. Disa rregulla për mbledhjen, administrimin dhe publikimin e rezultatit të zgjedhjeve

Rregullat për transmetimin dhe publikimin e rezultatit të zgjedhjeve përdoret aplikacioni kompjuterik i cili disponon disa kushte që duhet të mbahen parasysh nga GNV/KZAZ duke ndjekur procedurat e detajuara në udhëzimet përkatëse të KSHZ për përcaktimin e rregullave për mbledhjen, administrimin, publikimin e rezultatit të zgjedhjeve dhe miratimin e modeleve të dokumenteve që përdoren për nxjerrjen e rezultateve të zgjedhjeve për kuvendin e Shqipërisë.

XII. Dërgimi i materialeve zgjedhore në KQZ

Formatted: Font: (Default) Times New Roman

KZAZ është përgjegjëse për ruajtjen e dokumentacionit të zgjedhjeve, materialeve zgjedhore. Menjëherë pas nxjerrjes së rezultatit të zgjedhjeve në ZAZ, Kryetari, Zv. Kryetari dhe Sekretari i KZAZ dorëzojnë, me procesverbal, në KQZ, dokumentacionin e Zgjedhjeve e materialet zgjedhore, si dhe regjistrimin filmik të procesit të regjistrimit për shfaqjen e fletëve të votimit përpara vlerësimit të tyre dhe vlerësimit të çdo flete votimi, i cili ruhet në mënyrë elektronike. Asnjë procesverbal i KZAZ-së nuk mund të asgjësohet pa miratimin paraprak të KQZ-së.

Formatted: Font: (Default) Times New Roman

Në rast se nuk do të dorëzohen të gjitha materialet e inventarizuara, vlera financiare e tyre do të mbahet nga pagesa e anëtarëve të KZAZ-së.

Formatted: Font: (Default) Times New Roman, 12 pt